



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2369, datë 10.10.2013

Për

Projektvendimin për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2327, datë 28.06.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 10.10.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2327, datë 28.06.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.””.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe interkoneksionin” e ndryshuar.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2327, datë 28.06.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.””.
2. Shkresa me nr. 4275Prot, datë 15.7.2013, me anë të së cilës Albtelecom sh.a. ka depozituar “Pretendimet me shkrim të shoqërisë Albtelecom mbi procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”.
3. Korrespondenca me e-mail e zhvilluar mes palëve;
4. Raporti shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Raporti*),
si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me anë të Vendimit nr. 2327, datë 28.6.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.” në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
 - Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit. Të njoftohen palët e interesuara Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
 - Të njoftohen palët e interesuara Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
 - Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit”;

2. Në vijim të vendimit të lartpërmendur, bazuar edhe në nenin 60, të ligjit nr. 9918, Albtelecom sh.a. me shkresën nr. 4275Prot, datë 15.7.2013, ka depozituar “*Pretendimet me shkrim të shoqërisë Albtelecom mbi procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.pk.k dhe Albtelecom sh.a.*”.

Albtelecom shpjegon se, Enet me datë 17.12.2012, ka paraqitur “*Kërkesë për lidhje Marrëveshje Interkoneksioni*”. Albtelecom pasi e ka shqyrtuar kërkesën ka konstatuar se nuk përmbante informacionin e nevojshëm për të mundësuar zgjidhjen teknike dhe komerciale të akses/interkoneksionit dhe i ka kërkuar Enet me shkresën e datës 23.1.2013 plotësim të dokumentacionit sipas RIO-s së miratuar me VKD 1884, datë 19.4.2012.

Enet ka vijuar me plotësimet në dokumentacion më datat 29.1.2013 dhe 8.2.2013. përsëri Albtelecom e ka njoftuar Enet për plotësime si dergimi i kopjeve origjinale ose të noterizuara të dokumenteve. Më datë 21.3.2013, Enet ka dërguar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar.

Albtelecom me shkresën nr. 1191/1Prot, datë 12.4.2013, ka njoftuar Enet sh.p.k., duke e vënë në dijeni për ndryshimet e ndodhura në rrjetin e vet në kuadër të investimeve të mëdha dhe kalimin në teknologjinë IP dhe migrimin në rrjetin NGN/NGA dhe mbi efektet që do të shkaktojnë kjo arkitekturë e re në interkoneksionin mes rrjeteve me të gjithë operatorët. Në lidhje me këtë ndryshim Albtelecom i ka kërkuar Enet dokumentacionin teknik të përditësuar për realizimin e interkoneksionit në vijim të ndryshimeve.

Me shkresën nr. 1191/3Prot, datë 7.6.2013 Albtelecom ka informuar Enet ndër të tjera se dokumentacioni i dorëzuar është i paplotësuar dhe si i tillë në zbatim të pikës 6 të nenit 4, të RIO-s së miratuar nga AKEP, kërkesa e Enet për interkoneksion nuk konsiderohet e plotë.

Albtelecom shpjegon se Enet aktualisht nuk ka depozituar ende informacion lidhur me numrin e abonentëve ekzistues të tij në momentin e paraqitjes së kërkesës për interkoneksion të vërtetuar me evidencat përkatëse si dhe historikun e të dhënave për trafikun e gjeneruar nga abonentet e Enet (*origjinim/tranzitim/terminim*) sipas raporteve të dorëzuara në AKEP.

Në përfundim Albtelecom shprehet se:

Pretendimi i Enet se Albtelecom është në shkelje të çdo afati ligjor dhe afateve të RIO-s për lidhjen e MI, nuk qëndron pasi në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 9918, dhe me nenin 4, pika 6 e RIO-s së Albtelecom, afati për realizimin e interkoneksionit fillon nga momenti i dorëzimit nga ana e operatorit përfitues të kërkesës dhe dokumentacionit të plotë.

Sa më sipër, Albtelecom në zbatim të ligjit nr. 9918, dhe ligjit nr. 8485 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 99 e vijues, “*Rregullores për akses dhe interkoneksion*” neni 15, dhe “*Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*” nenet 5, 5, kërkon:

Lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit mes palëve, vetëm pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara në RIO-n e Albtelecom, neni 4, pika 5 dhe 6 e saj.

3. Enet sh.p.k, nuk ka depozituar pretendime sipas kërkesës së pikës 4 të VKD Nr. 2327, datë 28.06.2013. KZM ka kontaktuar me email me datë 16.9.2013 Enet dhe Albtelecom. Enet i është vënë në dukje se nuk ka depozituar pretendime sipas kërkesës së pikës 4 të VKD Nr. 2327, datë 28.06.2013, si dhe të dy paleve i'u kerkua të japin informacion në lidhje me procesin/mosmarrveshjen, duke patur parasysh edhe Vendimin nr. 2325, datë 28.06.2013 për *“Shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”*.
4. Enet ka konfirmuar me *e-mail* me datë 18.09.2013 se ka realizuar një takim më dt. 9.9.2013 rreth këtij problemi dhe se Albtelecom ka shprehur gatishmërinë për lidhjen e interkoneksionit duke marre parasysh vendimin e AKEP nr. 2325, datë 28.06.2013 për *“Shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”*. Enet sh.p.k ka konfirmuar gjithashtu se më dt. 12.09.2013 sipërmarrësi ofertues Albtelecom sh.a i ka dërguar me *e-mail* draft marrëveshjen e interkoneksionit dhe se Enet sh.p.k është tashmë në proces të përfundimit për pranimin dhe nënshkrimin e saj.
5. Albtelecom ka konfirmuar më dt. 18.09.2013 se duke patur parasysh edhe Vendimin nr. 2344, datë 30.08.2013 për *“Shfuqizimin/Ndryshimin e Vendimit Nr. 2325, datë 28.06.2013 të KD së AKEP “Për Shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”*, përfaqësuesi i subjektit Enet është ftuar në një takim në ambientet e Albtelecom më datë 9.9.2013 për vijimin e negociatave të Marrëveshjes së Interkoneksionit mes palëve. Gjatë këtij takimi, palët kanë rrënë dakord lidhur me zgjidhjen teknike të interkoneksionit si dhe trajtuan dhe sqaruan problematika të tjera rreth marrëveshjes. Gjithashtu, më datë 12.09.2013 është dërguar në mënyre elektronike Draft Marrëveshja e Interkoneksionit për tu plotësuar nga ana e Enet. Albtelecom përfundon duke cituar se është në pritje të dërgimit të draftit nga ana e Enet për vijimin e procedurave të mëtejshme për nënshkrimin e marrëveshjes
6. AKEP, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet sa më sipër, gjykon se:
 - a. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.2325, datë 28.06.2013 për *“Shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”*, si dhe Vendimi nr. 2344, datë 30.08.2013 për mosndryshimin e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të tij duke rrëzuar ankimin administrativ të Albtelecom sh.a, thellon bindjen dhe gjykimin e AKEP se arsyetimet e tyre ligjore dhe teknike të materializuara me dispozitivin e këtyre vendimeve kanë eliminuar tashmë shkakun (*lëndën*) e mosmarrëveshjes midis palëve, pasi referuar këtyre akteve administrative në fuqi sipërmarrësi Albtelecom sh.a duhet të japë akses për lidhjen e interkoneksionit në Elbasan, duke plotësuar kështu kërkesën e sipërmarrësit Enet sh.p.k.
 - b. Gjithashtu, nga pretendimet e Albtelecom për AKEP rezulton se Enet sh.p. nuk ka plotësuar tërësisht kërkesat e RIO-s së Albtelecom për informacionin që duhet t'i japë Albtelecom.

- c. Konstatohet se palët janë duke arritur marrëveshjen bazuar në parashikimet e RIO-s si dhe vendimeve më të fundit të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A,

V E N D O S:

1. Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2327, datë 28.6.2013, për *“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”*.
2. Palët të lidhin marrëveshjen e interkoneksionit sipas përcaktimeve të ofertës referencë të interkoneksionit në fuqi të Albtelecom sh.a.
3. Të njoftohen palët e interesuara Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Elkeda DOMI**
4. **Zamira NURÇE**